

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Emine Kaçiku dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, lidhur me ankesën administrative të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.ZL.nr.1142/2017, datë 23.12.2017, në seancën e mbajtur më 26.12.2017, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) nga Prishtina, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.ZL.nr.1142/2017, datë 23.12.2017.

A r s y e t i m i

Në pikën I të vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.ZL.nr.1142/2017, datë 23.12.2017, është hedh poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (shkurt. AAK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Kryetar të Komunës së Istogut, në pjesën që ka të bëjë me parregullsitë e paraqitura për ditën e Rivotimit për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura me datë 17.12.2017. Në pikën II të këtij vendimi është refuzuar si e pabazuar ankesa e subjektit politik (AAK), në pjesën që ka të bëjë me rezultatin përfundimtar të ditës së Rivotimit, për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura me datën 17.12.2017.

Subjekti politik AAK i ka paraqitur ankesë kësaj Gjykate, me të cilën konteston ligjshmërinë e vendimit të përmendur, duke propozuar që ankesa të pranohet, të anulohet vendimi i PZAP A.ZL.nr.1142/2017 dt. 23.12.2017, të anulohet rezultati përfundimtar të Rivotimit, për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura me 17.12.2017 dhe të urdhërohet KQZ për të përsëritur votimin në Komunë të Istogut.



Në përgjigje të ankesës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) qëndroi në konstatimet e paraqitura në vendimin e vet dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në vështrim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes ndaj ankesës, shqyrtoi shkresat e tjera të lëndës dhe konstatoi:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.ZL.nr.1142/2017, datë 23.12.2017, në pikën I është hedh poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik AAK, paraqitur kundër vendimit të KQZ, pas shpalljes së rezultait përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kryetar të Komunës së Istogut, në pjesën që ka të bëjë me parregullsitë e paraqitura për ditën e Rivotimit për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura me 17.12.2017. Në pikën II të këtij vendimi është refuzuar si e pabazuar ankesa e AAK-së, në pjesën që ka të bëjë me rezultatin përfundimtar të ditës së Rivotimit, për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura me 17.12.2017.

Lidhur me pikën I, Gjykata vlerësoi se janë të pabazuara pretendimet e subjektit politik AAK, paraqitur në ankesën ndaj vendimit të kontestuar, të PZAP, sepse janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga Paneli Zgjedhor si dhe me provat që ndodhen në shkresat e lëndës. Parashtruesi i ankesës nuk i ka argumentuar me asnjë provë pretendimet e veta, kurse ato prova, të cilave u referohet, nuk janë me ndikim në marrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje juridike.

Në nenin 118.4 të Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në përputhje me nenin 12 par.2 të Ligjit nr.03/L-256 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është parashikuar që kundër vendimit të PZAP mund t'i paraqitet ankesa Gjykatës Supreme në afat prej 24 orësh, nga çasti i pranimit të vendimit të PZAP dhe ajo do të pranohet, nëse dënimi i shqiptuar tejkalon shumë prej 5.000,-(pesë mijë) euro, apo nëse çështja prek të drejtat themelore. Gjykata Supreme e merr vendimin brenda afatit prej 72 orësh, nga çasti i dorëzimit të ankesës.

Në nenin 115.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) parashikohet që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa është një organ i përhershëm dhe i pavarur, që është kompetent t'i marrë në shqyrtim ankesat dhe parashtresat që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, ashtu siç përcaktohet në këtë Ligj dhe në rregullat zgjedhore. Neni 117.2 i LZP së parashikon se gjatë vendosjes për një ankesë ose apel PZAP i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme. Me nenin 118.1 parashihet se PZAP i pranon



ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Nga këto arsye, kjo Gjykatë vlerëson se kjo fazë e procesit zgjedhor është e ankimeshme vetëm sa i përket vendimit të KQZ-së pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, dhe atë për parregullsitë e shkaktuar gjatë administratimit të të dhënave në QNR, mospërputhjet e FPR, FRK dhe provave që eventualisht i sjell pala që ka interes ligjor, e të cilat prova nuk përputhen me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, apo parregullsitë të cilat kanë qenë të ditura publikisht dhe që janë konsideruar nga paneli se mund të kenë ndikim drejtpërdrejt në rezultat final dhe që minojnë procesin zgjedhor, por nuk janë përmirësuar ose eliminuar nga KQZ, edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Kjo Gjykatë, poashtu, vlerëson se të gjitha parregullsitë që ndërlidhen me ditën e rivotimit, pra prej datës 18.12.2017 deri në ora 19, afati për të parashtruar ankesë në PZAP ka qenë 24 orë nga mbyllja e Qendrave të Votimit, e në këtë kuptim, sipas nenit 119.1 LZP lidhur me nenin 13.1 të Ligjit nr.03/L-073 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.03/L-256 për Zgjedhjet e Përgjithshme të R.Kosovës.

Dispozita ligjore e nenit 119.1 të LZP në.03/L-073 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.03/L-256 parasheh se personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar siaps këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa. Andaj, kjo Gjykatë vlerëson se PZAP ka vërtetuar drejt se parregullsitë gjatë procesit zgjedhor, përditën e Rivotimit, për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura me 17.12.2017 janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me ditën e votimit, e që afati për të parashtruar ankesë ishte 24 orë nga mbyllja e qendrave të votimit. Në këtë rast afati ka qenë deri me datën 18.12.2017, në ora 19.00. Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se PZAP-i ka vendos drejt me rastin e hedhjes së ankesës të subjektit politik AAK - si të palejuar, pika I e vendimit, pasi që afati i ankimit ishte 18.12.2017, deri në ora 19.00.

Sa i përket pikës II të vendimit të kotestuar me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e subjektit politik AAK, në pjesën që ka të bëjë me rezultatin përfundimtar të ditës së Rivotimit, për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura me 17.12.2017, sipas vlerësimit të Gjykatës, janë të pabazuara pretendimet e paraqitura në ankesë, sepse janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP.

Pretendimet ankimore se fillimisht KQZ e ka shpallur fitues kandidatin e AAK-së, Gani Dreshaj e pastaj duke u thirrur në gabime teknike, e ka shpallur fitues kundër kandidatin Haki Rugova nga LDK, çshtë pretendim i pabazuar, sepse KQZ, me rastin e shpalljes së rezultatit preliminar e ka publikuar se Gani Dreshaj është fituesi i zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut, por rezultati



preliminar është rezultat i ndryshueshëm dhe fleksibil në çdo kohë, andaj edhe nuk është i lejuar ankimimi ndaj këtij rezultati sepse i njëjti ndryshon varësisht nga procesimi i kutive të votimit, të cilat kanë qenë në numrim e sipër. Pas numrimit të të gjitha fletëvotimeve nga votuesit jashtë Kosove, dhe votuesit me kusht, shpallet rezultati përfundimtar i cili në këtë rast ka ndryshuar nga rezultati preliminar e që nuk do të thotë që rezultati preliminar të jetë i njëjtë me rezultatin përfundimtar sepse me rastin e publikimit të rezultatit preliminar procesi i numrimit ende është i papërfunduar.

Kjo Gjykatë, poashtu, vlerëson si të pabazuara pretendimet ku theksohet, se me vendimin e PZAP ju është privuar e drejta e votimit të gjithë votuesve për të votuar, e që është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës së R. Kosovës, ngase KQZ e merr Ekstraktin e Regjistrat Civil, të fundit me të gjithë votuesit që kanë të drejtë vote e dhe me ata votues që deri në ditën e votimit i mbushin 18 vjet dhe kanë të drejtë vote. Lista e votuesve për një palë zgjedhje certifikohet një herë dhe është e vlefshme për ato zgjedhje, sepse askush nuk mund ta dijë se sa mund të zgjasin zgjedhjet, por mund të dihet vetëm dita kur do të mbahen zgjedhjet, siç ka qenë data 22.10.2017. Dispozita ligjore nenit 6 të Rregullës Zgjedhore nr.10 thotë se 'Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave përcakton se lista e njëjtë e votuesve që është shfrytëzuar për zgjedhjet komunale, do të përdoret për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave'. Pra, lista e njëjtë e votuesve që është shfrytëzuar për ditën e votimit në këto zgjedhje lokale me datën 22.10.2017 do të shfrytëzohet edhe për raundin e dytë të këtyre zgjedhjeve.

Pretendimi në ankesë ku thuhet se KQZ me datën 11.12.2017 ka nxjerrë vendim për certifikimin e listës zgjedhore për Komunën e Istogut, duke i selektuar vetëm votuesit jashtë Kosove, andaj arsyetimi i PZAP-it ishte i pasaktë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate- nuk është i bazuar, ngase KQZ fillimisht nuk ka bërë certifikim selektiv duke u marr vetëm me votuesit jashtë Kosove, por KQZ, vendimin me nr.2533/2017 dt.11.12.2017 ka marrë duke u bazuar në vërejtjet e dhëna nga PZAP (Vendimi ZL.A.nr.1114/2017 dt.27.11.2017), i cili vendim është vërtetuar nga Gjykata Supreme AA nr.55/2017 dt.01.12.2017, me të cilat vendime KQZ ka qenë e obliguar të eviton parregullsitë e konstatuar në vendimet e lartpërmendura.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, e cila konstatoi se edhe e drejta materiale, po ashtu, është zbatuar drejt. Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj nuk i pranoi pretendimet ankimore të tij, ngaqë janë pa ndikim në konstatimin e një gjendjeje tjetër faktike nga ajo që ka vërtetuar PZAP.



Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 46 të Ligjit të Konfliktëve Administrative lidhur me nenin 118.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
AA.UZH.nr.64/2017, datë 26.12.2017

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Nebojsa Boriçiq

Përktheu:
Ferid Abazi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
